




PARALAJMËRIM


- Mos përdorni mjete për të përshpejtuar procesin e shkrijës ose për të pastruar aparaturën, të ndryshme nga ato të rekomanduara nga prodhuesi.
- Pajisja duhet të ruhet kështu për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një hapësirë të ajrosur mirë pa burime ndezëse në përdorim të vazhdueshëm (për shembull: flakë të dukshme, një pajisje gazi në përdorim apo një ngrohës elektrik në përdorim) dhe të ketë hapësirë të lirë siç përcaktohet në këtë manual për instalim.
- Nyjet e bëra në instalimin midis pjesëve të sistemit ftohës duhet të jenë të arritshme për qëllime të mirëmbajtjes.
- Mos përdorni nyje të cilat tashmë janë përdorur një herë.
- Sigurohuni që instalimi, shërbimi, mirëmbajtja dhe riparimi të zbatohen udhëzimin nga Daikin dhe mbi të gjitha të përputhen me legjislacionin e aplikueshëm (për shembull normën kombëtare të gazit) dhe të realizohen vetëm nga një person i kualifikuar.
- Mos e shponi apo digjni.
- Jini të vetëdijshëm se lënda ftohëse R32 nuk ka aromë.

KËRKESAT E HAPËSIRËS SË INSTALIMIT

- Instalimi i tubave duhet mbajtur në minimum.
- Tubat duhen mbrojtur nga dëmtimi fizik dhe nuk duhet të instalohen në një hapësirë të pa ajrosur, nëse hapësira është më e vogël se hapësira minimale siç përcaktohet në tabelën e mëposhtme.
- Për instalim brenda një ndërtese (kjo aplikohet në njësitë e brendshme dhe të jashtme të instaluara brenda) mund të nevojitet një hapësirë minimale nga dyshemeja. Kjo përcaktohet në diagramën në të djathtë dhe në tabelën e mëposhtme. Tabela përmban shifra të rumbullakosura. Për një përcaktim më të saktë, vlerat mund të përcaktohen nga diagrami në anën e djathtë.
- Për njësitë e jashtme të instaluar brenda (kopsht dimëror, garazh, dhoma e makinerive etj.) përdorni përcaktimin për njësitë me vendosje në dysheme. Nëse njësia e jashtme është instaluar në lartësinë e 1,8 metrave apo më shumë mbi tokë, është e mundur të përdoret përcaktimi i njësisë të montuara në mur.
- Për të përcaktuar hapësirën minimale nga dyshemeja, ngarkesa e plotë e lëndës ftohëse duhet të merret parasysh (vlera e plotë, që është shuma e ngarkesës para ① dhe ngarkesa e fushës shtesë ②).
- Hapësira minimale nga dyshemeja [m²] përcaktohet bazuar në lartësinë e instalimit në 1,8m për njësitë e montuara në mur dhe 2,2m për njësitë e montuara në tavan.



Kërkesat e instalimit për njësitë R32



Hapësira minimale nga dyshemeja për aparaturën e instaluar brenda (aplikohet në njësitë e brendshme dhe të jashtme të instaluara brenda)

Njësitë e montuara në tavan		Njësitë e montuara në mur		Njësitë me vendosje në dysheme	
m (kg)	A _{min} (m ²)	m (kg)	A _{min} (m ²)	m (kg)	A _{min} (m ²)
1,224	Pa kufizim	1,224	Pa kufizim	1,224	Pa kufizim
1,225	0,96	1,225	1,43	1,225	12,88
1,3	1,08	1,3	1,61	1,3	14,50
1,4	1,25	1,4	1,87	1,4	16,82
1,5	1,44	1,5	2,15	1,5	19,31
1,6	1,63	1,6	2,44	1,6	21,97
1,7	1,84	1,7	2,76	1,7	24,80
1,8	2,07	1,8	3,09	1,8	27,80
1,9	2,30	1,9	3,44	1,9	30,98
2,0	2,55	2,0	3,81	2,0	34,32
2,1	2,81	2,1	4,20	2,1	37,84
2,2	3,09	2,2	4,61	2,2	41,53
2,3	3,38	2,3	5,04	2,3	45,39
2,4	3,68	2,4	5,49	2,4	49,42
2,5	3,99	2,5	5,96	2,5	53,63
2,6	4,31	2,6	6,44	2,6	58,00
2,7	4,65	2,7	6,95	2,7	62,55
2,8	5,00	2,8	7,47	2,8	67,27
2,9	5,37	2,9	8,02	2,9	72,16
3,0	5,74	3,0	8,58	3,0	77,22
3,1	6,13	3,1	9,16	3,1	82,46
3,2	6,54	3,2	9,76	3,2	87,86
3,3	6,95	3,3	10,38	3,3	93,44
3,4	7,38	3,4	11,02	3,4	99,19
3,5	7,82	3,5	11,68	3,5	105,11